

Gjykata Themelore në Prizren
P.nr.93/14
31 korrik 2014

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren me trup gjykues të përbërë nga Gjyqtarja nga EULEX Marie Tuma në cilësinë e kryetares së trupit gjykues dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët Skender Cocaj dhe Artan Sejrani, me ndihmën e proces-mbajtëses Vlora Johnston në lëndën penale ndaj

S. V., emri i babait Q. emri i nënës O., i lindur më [] në fshatin [], komuna e Titov Veles, adresa e fundit në Rrugën [], me kombësi shqiptare, nënshtetësi të Maqedonisë, punëtor, i martuar, baba i [] fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore. S. V. gjendet në paraburgim që nga 23 maj 2014, masë e cila skadon më 22 shtator 2014.


S. V. akuzohet për veprën penale:

Vrasje në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2, pika 3, Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, hapur për publikun, më 10 qershor, 23 qershor, 24 qershor, 27 qershor dhe 25 korrik 2014 në prani të të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës S. M., prokurorit publik Danilo Çeçarelli, palës së dëmtuar Sh. Q. dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar avokates B. B., trupi gjykues pleqëroi dhe votoi më 25 korrik 2014, në pajtim me nenin 383 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, shpall publikisht si në vijim:

AKTGJYKIM

I pandehuri S. V., me të dhënat personale si më lart, i akuzuar për vrasje në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2, pika 3, Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës



LIROHET NGA AKUZAT E AKTAKUZËS

Sipas aktakuzës së datës 10 shtator 2010, ndryshuar më 17 dhjetor 2012, S. V. akuzohet se për përfitime personale, pra marrjen e veturës së viktimes, Audi 80, me targa të regjistrimit , me ngjyrë të kuqe, i mori jetën A. Q. më 9 gusht 1999 në një vend të panjohur në mes Prizrenit dhe Karaqices/Luzhnice, ku mbetjet mortore të viktimës janë gjetur më 16 gusht 2000 dhe më vonë më 10 korrik 2002.

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Në pajtim me nenin 99, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, shpenzimet e procedurës penale paguhen nga burimet e buxhetit.

PARABURGIMI

Paraburgimi ndërpritet që sot dhe do të lëshohet një Vendim i veçantë.

ARSYETIMI

Vendimet procedurale dhe provat e administruara:

1. Me pajtimin e prokurorit publik dhe avokatit mbrojtës, trupi gjykues vendosi të zbatojë Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës më 6 prill 2004 (KPPK) në pajtim me nenin 544 të Kodit të Procedurës së Republikës së Kosovës (KPRK).
2. Me parashtrësën e prokurorit publik, trupi gjykues ftoi dëshmitarët J. M. dhe A. Sh. Pala e dëmtuar Sh. Q. është ftuar po ashtu.
3. Me parashtrësën e avokatit mbrojtës, trupi gjykues ftoi dëshmitarët E. K. dhe E. K. lidhur me gjendjen financiare të të pandehurit në vitin 1999.
4. Në pajtim me prokurorin publik dhe avokatin mbrojtës, trupi gjykues pranoi si prova deklaratat e dëshmitarëve të listuar nën Provat e listuara në pajtim me nenin 368, paragrafi 3, KPPK dhe që të gjitha deklaratat e listuara janë konsideruar si të lexuara gjatë shqyrtimit



kryesor. E njëjta gjë vlen edhe për provat e shkruara, të shënuara nën Provat e paraqitura në pajtim me nenin 368, KPPK.


5. Prokurori publik, avokati mbrojtës dhe përfaqësuesja e palës së dëmtuar, avokatja B. R. B., kanë sjellë fjalët e tyre përfundimtare para trupit gjykues me shkrim më 27 korrik 2014.

Historiku Procedural

6. Më datë 3 qershor 2008, Prokurori i Qarkut në Prizren nxori Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve (HP. nr. 143/08) kundër të pandehurit S. V. për veprën penale Vrasje e Rëndë, sipas Nenit 147, paragrafi 7, Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës, e cila dënohet me të paktën 10 vjet burgim apo burgim afat-gjatë.
7. Më datë 9 korrik 2009 Prokurori Publik i EULEX-it nxori një Aktvendim mbi pezullimin e hetimeve kundër të pandehurit S. V.
8. Më datë 12 qershor 2010 i pandehuri u arrestua në Kroaci sipas një Fletë-rreshtimi Ndërkombëtar nxjerrë më datë 22 tetor 2009 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. S. V. u ekstradua në Kosovë më datë 6 gusht 2010 sipas kërkesës së Prokurorit Publik të EULEX-it parashtruar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës më datë 22 qershor 2009.
9. Më datë 6 gusht 2010 Prokurori Publik i Qarkut rifilloi hetimet kundër S. V. Gjykatësi i procedurës paraprake pranë, në atë kohë, Gjykatës së Qarkut Prizren vendosë të vërë të pandehurin nën masën e paraburgimit.
10. Më datë 10 shtator 2010, Prokurori Publik i Qarkut ngriti aktakuzë (HP.nr.143/08; HEP. Nr. 118/08) kundër të pandehurit S. V. për veprën penale të Vrasjes, në pajtim me Nenin 30 paragrafi 2 pika 3 LPK. Në pajtim me Nenin 38 paragrafi 2, KP RSFJ, më datë 4 tetor 2010 aktakuza i konfirmua nga gjykatësi konfirmues.
11. Gjykata e Qarkut Prizren filloi shqyrtimin kryesor kundër të pandehuri S. V. më datë 9 dhjetor 2010 dhe shpalli aktgjykimin më datë 23 mars 2011 me anë të të cilit i pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua me shtatëmbëdhjetë vjet burgim. Masa e paraburgimit u vazhdua derisa aktgjykimi u bë i plotfuqishëm.



12. Gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata e shkallës së parë mori në pyetje të akuzuarin, *S.V.*, dhe dëshmitarët vijues: *I.M.*, *H.K.* dhe *SH.Q.* (9 dhjetor 2010), *B.H.*, *A.SH.*, *I.B.* dhe Afrim Bytyqi (10 dhjetor 2010), *M.D.* dhe *G.K.* (24 janar 2011), *M.H.* dhe *SH.A.* (25 janar 2011), *F.S.* dhe *Y.B.* (4 shkurt 2011) dhe *E.D.* (17 mars 2011). Më tej, në pajtim me Nenin 368, paragrafi 3, KPPK, o morën në konsideratë edhe provat e mëposhtme: përmbledhje e vendit të ngjarjes, përpiluar nga Policia e Kosovës, datë 17 mars 2005: skica e vendit ku u gjetën mbetjet mortore të viktimës *A.Q.* nga *A.B.* Vërtetimi i Identitetit, lëshuar nga Zyra e Personave të Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore (ZPZHML) datë 5 dhjetor 2002; raporti i autopsisë EX2002-126 i ZPZHML (FZX01/001BP/MPU 2000) (identifikimi i mbetjeve mortore të viktimës); informatat e Sistemit të Informacionit të Veturave të Kosovës lidhur me veturën Audi 80, ngjyrë e kuqe në emër të pronarit *B.S.*, datë 15 janar 2004: kontrata e shitblerjes së veturës Audi 80 mes viktimës Ajdin Qereti dhe pronarit të parë të veturës, *N.B.* datë 17 korrik 1998; trata e shitblerjes së veturës Audi 80 Audi 80 mes *A.M.* dhe kompanisë Venera Tours datë 20 nëntor 2001; dokumentet e regjistrimit të veturës Audi 80, ngjyrë e kuqe; fotografi të veturës Audi 80, ngjyrë e kuqe, të bëra nga policia dhe dokumentet e dërguara nga zyra për regjistrimin e veturave Ferizaj/Urosevac.
13. Avokati mbrojtës i të akuzuarit, përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe prokurori publik i qarkut Prizren parashtuan ankesa të afatshme kundër aktgjykimit dhe për më tepër prokuroria speciale sfidoi aktgjykimin e shkallës së parë.
14. Më datë 12 qershor 2012 Gjkata Supreme e Kosovës, në bazë të gjetjeve të saj nxori Aktvendim në favor të avokatit mbrojtës të të pandehurit *S.V.*. Gjkata Supreme e Kosovës aprovoi parashtresën e avokatit mbrojtës. Gjkata Supreme, përmes aktvendimit anuloi aktgjykimin e shkallës së parë dhe lënda u kthye për ri-gjykim në Gjykatën e Qarkut Prizren. Në të njëjtin Aktvendim Gjykata Supreme e Kosovës nuk aprovoi parashtresën e avokatit mbrojtës për ndërprerjen e paraburgimit. Ankesat e prokurorisë dhe



- të palës së dëmtuar nuk u morën parasysh lidhur me meritat e lëndës dhe u lanë mënjanë.
15. Gjkata e Qarkut Prizren filloi ri-shqyrtimin kryesor më datë 30 tetor 2012 dhe zhvilloi seanca më datë 17,18,19 dhe 21 dhjetor kundër të pandehurit **S.V.**. Gjatë ri-gjykimit u administruan të njëjtat prova si gjatë gjykimit të parë me një dëshmitar shtesë, dëshmitarin ekspert **A.R.** i cili u dëgjua më datë 19 dhjetor 2012, në cilësinë e shefit të departamentit të Mjekësisë ligjore të EULEX-it. Deklaratat e dëshmitarëve të dhëna gjatë shqyrtimit të parë u futën në procesverbal. Për arsye të ndryshme trupi gjykues vendosi që të mos ftojë **J.M.** si dëshmitar. Trupi gjykues nuk e aprovoi kërkesën parashtruar nga avokati mbrojtës për të ftuar **R.B.** dhe **E.K.** si dëshmitarë lidhur me gjendjen financiare të të pandehurit **S.V.** në vitin 1999 sepse, sipas trupit gjykues, këta persona nuk kanë patur qasje në të dhënat financiar të të pandehurit përveç shpenzimeve të tij ditore.
 16. Në bazë të gjetjeve, më datë 24 dhjetor 2012, Gjkata e Qarkut Prizren shpalli aktgjykimin duke gjetur të pandehurin **S.V.** jo fajtor dhe masa e paraburgimit u ndërpre nga trupi gjykues.
 17. Prokurori Publik Themelor i Prizrenit parashtrroi ankesë të afatshme kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prizren dhe kundërshtoi aktgjykimin e datës 24 dhjetor 2012.
 18. Më datë 22 janar 2014 Gjkata e Apelit të Kosovës, pasi shqyrtoi dosjen e lëndës dhe aktgjykimin e kundërshtuar nxori Aktvendim duke aprovuar ankesën e prokurorit dhe ktheu lëndën për ri-gjykim në Gjykatën Themelore Prizren.
 19. Më datë 23 prill 2014, prokurori i EULEX-it parashtrroi kërkesë për të nxjerrë Urdhër për Arrestimin e të pandehurit **S.V.** sipas Nenit 270 (1) lidhur me Nenin 281 (1) KPPK me qëllim që të sigurohet fillimi i procedurës penale.
 20. Më datë 23 maj 2014 kryetari i trupit gjykues mori vendim lidhur me kërkesën e prokurorit duke e aprovuar atë. Më datë 23 maj 2014 i pandehuri **S.V.** u arrestua dhe u soll para kryetarit të trupit gjykues gjatë seancës për masën e paraburgimit.



Provat e paraqitura:

I. Dëshmitarët

21. Gjatë shqyrtimit kryesor, deklaratat e dhëna nga dëshmitarët si në vijim gjatë shqyrtimit kryesor janë futur në procesverbal:

- S. Q. (deklarata e dhënë më 9 dhjetor 2010)
- J. M. (deklarata e dhënë më 9 dhjetor 2010)
- H. K. (deklarata e dhënë më 9 dhjetor 2010)
- B. M. (deklarata e dhënë më 10 dhjetor 2010)
- A. S. H. (deklarata e dhënë më 10 dhjetor 2010)
- A. B. (deklarata e dhënë më 24 janar 2011)
- M. D. (deklarata e dhënë më 24 janar 2011)
- G. K. (deklarata e dhënë më 24 janar 2011)
- S. A. (deklarata e dhënë më 25 janar 2011)
- M. H. (deklarata e dhënë më 25 janar 2011)
- F. S. (deklarata e dhënë më 4 shkurt 2011)
- Y. B. (deklarata e dhënë më 4 shkurt 2011)
- E. D. (deklarata e dhënë më 17 mars)
- A. R. (deklarata e dhënë më 19 dhjetor 2012)

Më 23 qershor 2014 pala e dëmtuar **S. Q.** u dëgjua në cilësinë e palës së dëmtuar dhe dëshmitarit.


Më 23 qershor 2014 janë dëgjuar dëshmitarët Elhame Kelmendi dhe Enver Krasniai në cilësinë e dëshmitarëve.

Më 23 qershor 2014 është dëgjua **A. S. R.** në cilësinë e dëshmitarit.

Më 23 qershor 2014 është dëgjua **J. M.** në cilësinë e dëshmitarit.

II. Provat me shkrim

22. Përpos kësaj, provat si në vijim nga dosja e lëndës janë marrë parasysh dhe janë konsideruar si të lexuara në pajtim me nenin 368, paragrafi 3, KPPK: Përmbledhje nga Vendi i Ngjarjes, përpiluar nga Policia e Kosovës më 17 mars 2005, skica e vendit ku janë gjetur mbetjet mortore të viktimës **A. Q.** nga **A. B.** Konfirmimi i Identitetit lëshuar nga Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësisë Ligjore (ZPHML) i datës 5 dhjetor 2002, raporti i autopsisë EX2002-126 nga ZPHML (FZX01/001BP/MPU) (identifikimi i mbetjeve mortore të viktimës), informata nga Sistemi Informativ i Kosovës për Vetura lidhur me veturën Audi 80, ngjyrë e kuqe, në emër të pronarit **B. S.** të datës 15 janar 2004, kontrata për



blerje të veturës përkatëse Audi 80 në mes viktimës **A.Q.** dhe pronarit të parë të veturës, **N.B.** i më datë 17 korrik 1998, kontrata mbi blerjen e veturës përkatëse Audi 80 në mes **A.M.** dhe kompanisë "Venera Tours" më datë 20 nëntor 2001, dokumentet për regjistrim të veturës Audi 80, e kuqe, fotografi të veturës Audi 80, e kuqe, bërë nga policia dhe dokumente të dërguara nga Zyra për Regjistrim të Veturave në Ferizaj/Urosevac.

III. Dëgjimi i të pandehurit **S.V.**


23. Më 27 qershor 2014, është dëgjuar i pandehuri **S.V.** **S.V.** është dëgjuar disa herë para datës 27 qershor 2014; 17 gusht 2010, 17 mars 2011 dhe 19 dhjetor 2012 si dhe është intervistuar më 5 mars 2004.

Qëndrimi i Prokurorit Publik

24. Prokurori deklaroi para trupit gjykues se prokuroria ka demonstruar përtej dyshimit të arsyeshëm nëpërmjet deklaratave të dëshmitarëve, dëshmime, dhe të gjitha provave materiale dokumentuese se i pandehuri **S.V.** vrau **A.Q.** dhe propozoi që **S.V.** të gjykohej për vrasje për shkak se shtiu në viktimën me armë zjarri në kokë ose se e goditi atë aq shumë me një mjet të topitur sa që i shkaktoi vdekjen dhe pastaj varrosjen e viktimës në një varr të cekët menjëherë pas fshatit Karaqice.

25. Prokurori i referohet pretendimeve specifike faktike në parashtrësën e tij lidhur me qëndrimin e **S.V.** në spitalin e Prizrenit, marrëdhënies mes **S.V.** dhe viktimës dhe disa nga dëshmitarët, përfshirë edhe **A.S.H.**, ngjarjes së 8 gushtit dhe asaj së 9 gushtit, dhe blerjen e pretenduar të veturës që i takonte viktimës dhe në fund përmbajtjes së autopsive të kryera më 21 shtator 2000 nga Tribunali dhe 5 dhjetor 2002 nga Zyra e UNMIK-it për Persona të Zhdukur dhe raportit të antropologut të mjekësisë ligjore më datë 3 dhjetor 2012 dhe mendimit të ekspertit, antropologut/arkeologut **A.R.**

26. Prokurori pohon se lënda përmban prova rrethanore. Prokurori deklaroi se bazuar në të gjitha provat e mbledhura dhe të paracitura në lëndën aktuale, provat janë të mjaftueshme për të përjashtuar të gjitha mundësitë e tjera të mundshme përpos asaj që viktima **A.Q.**



është vrarë dhe kryerësi i kësaj vrasje është i pandehuri

S.V.

27. Prokurori i referohet rrethanave të mëposhtme;

I pandehuri ishte njëri ndër personat e fundit që pa viktimën në jetë, i pandehuri kishte shprehur qëllimin për të vrarë kur ai, sipas deklaratave të dëshmitarit A. SH. (20 shkurt 2004, 13 mars 2004, 10 qershor 2009, 10 dhjetor 2010 dhe 23 qershor 2014) më 8 gusht derisa po pushonte në një restorant në Malishevë i tha dëshmitarit se të nesërmen (më 9 gusht 1999) "do të shkonte me A. në Prishtinë, ai do të merrte veturën e tij dhe do t'a kryenim me të pasi që kam dëgjuar se nuk është njeri i mirë". S.V. nuk e lejoi A. SH. të shkonte me të në Prishtinë më 9 gusht 1999 për shkak se nuk dëshoi të kishte dëshmitarë. Viktima nuk donte të shiste veturën e tij, Audi 80 me ngjyrë të kuqe. Plani i viktimës ishte të shkonte në Prishtinë apo Mitrovicë më 9 gusht 1999. Nuk ekzistojnë prova që tregojnë se viktima ka dashur të shesë veturën. S.V. nuk kishte të hollat për të blerë veturën dhe nuk kishte për qëllim të shiste veturën dhe nuk kishte kontratë për blerje, vetura asnjëherë nuk është regjistruar në emër të S.V., nuk e kishte vozitur veturën para se t'a blinte atë dhe nuk e mbajti veturën por e shiti për shkak se S.V. e dëshoi veturën në mënyrë që të përfitojë nga ajo. S.V. asnjëherë nuk është përpjekur të kontaktojë viktimën pas datës 9 gusht 1999 dhe asnjëherë nuk është kthyer në Prizren. I pandehuri e njëj mirë rrethinën e vendit ku është gjetur trupi i pajetë. S.V. nuk ka përdorur paterica. Ai po ashtu është parë në Shtime rreth datës së zhdukjes. Viktima nuk kishte armiq. S.V. nuk i tha lamtumirë S.H.A. pasi që është larguar nga shtëpia e tij. Për fund, S.V. i njëj mirë armët dhe akoma edhe sot është shumë i dhunshëm dhe i rrezikshëm.

28. Prokurori po ashtu deklaroi se i pandehuri S.V. ndryshoi deklaratat e tij në vende të caktuara kur është marrë në pyetje gjatë shqyrtimeve të ndryshme kryesore.

Pozita e të pandehurit

29. I pandehuri është deklaruar i pafajshëm. Ai ishte plagosur me copëza shrapneli më 6 qershor 1999 dhe kishte akoma shrapnel në këmbën e djathtë. Ai ishte shtruar në një spital në Krumë dhe pastaj ishte transferuar në spitalin e Tiranës dhe pastaj në spitalin e Prishtinës. Gjithsej, ai i është nënshtruar katër operacioneve. Ai ecte me paterica deri më tetor - nëntor të vitit 1999. Ai deklaroi se gjatë



shtrimit të tij në spital, ai ishte bërë shokë me viktimën A.Q. dhe SR.A. dhe SH.A. Viktima A.Q. dhe SH.A. e kishin vizituar çdo ditë që kishte qenë i shtrirë ky në spital. A.Q. dhe SR.A. morën S.V. në shtëpi të SH.A. pas daljes së tij nga spitali në Prizren. Ai kishte qëndruar në këtë shtëpi për afërsisht një apo dy javë. Pas kësaj, ai ishte pranuar në spitalin e Prishtinës. I pandehuri deklaroi se ka qëndruar në shtëpi të SH.A. për rreth një apo dy javë pas daljes së tij nga spitali. A.SH dhe S.V. janë bërë shokë sepse kishin ndarë të njëjtën dhomë si pacientë në spital. A.Q. në disa raste kishte vozitur S.V. për në spitalin e Prishtinës për kontrole.

30. I pandehuri deklaroi se më 9 gusht 1999 së bashku me viktimën A.Q., ai ishte larguar, dhe kishin shkuar në kafenenë Café Kosova në Prizren ku ai bleu veturën, Audi 80, me ngjyrë të kuqe, nga viktimja S.V. pagoi 2.100 DM për veturën. Nuk është përpiluar ndonjë kontratë. I pranishëm gjatë marrëveshjes ishte edhe një person me emrin A. nga Ferizaji i cili po ashtu kishte qëndruar në spitalin e Prizrenit. S.V. deklaroi se ka blerë veturën me fitimet e tij nga puna që kishte bërë në Gjermani. Pas blerjes, A.Q. është larguar me tre persona, identiteti i të cilëve nuk ishte i njohur për S.V. S.V. është larguar nga Prizreni dhe shkoi te e motra e tij në Ferizaj. Pas një kohe të shkurtër, ai shiti veturën për 2.500 DM në tregun për makina në Prishtinë ndërsa kishte vështirësi t'a voziste për shkak të lëndimeve në këmbë. Ai ishte informuar mbi vdekjen e S.V. në vitin 2004 kur ishte intervistuar nga policia. S.V. deklaroi se e njeh fshatin Karaqic për shkak se e motra e tij kishte jetuar në atë rajon para luftës. I pandehuri sqaroi se është bashkë-pronar i një prone dhe një toke në Maqedoni siç ishte edhe në vitin 1999.

Vlerësimi i Gjykatës mbi Provat

31. Gjykata thekson se, në vlerësimin e provave në lëndën aktuale, ajo adopton standardin e njohur "përtej dyshimit të arsyeshëm" siç është cekur dhe aplikuar në lëndën El-Masri v. *Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*, Aktgjykimi 13.12.2012 nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Prokuroria duhet të vërtetojë lëndën e saj përtej dyshimit të arsyeshëm.



Gjetjet Faktike të Gjykatës

32. I pandehuri S. V. e ka takuar viktimën A. Q. dhe Sh. A. dhe A. Sh. në korrik 1999 kur ai është shtrirë në spital në Prizren për shkak të një lëndimi në këmbë nga lufta. Kur ai është lëshuar nga spitali S. V. është ftuar që të qëndrojë në shtëpinë e Sh. A. për rreth një apo dy javë. Më 9 gusht 1999 viktima A. Q. është larguar nga shtëpia e tij rreth orës 07.30 dhe ka shkuar në vendin e tij të punës – “Kosova Printing House”. Ai ka kërkuar leje nga Drejtori i Shtypshkronjës, M. D., që të shkojë në një udhëtim privat në Mitrovicë dhe pastaj nga ai është kërkuar që të sjellë bojë në shtypshkronjë. Ai gjithashtu e ka takuar punëdhënësin e tij G. K. në mëngjes në vendin e tij të punës. Para se të largohet nga vendi i punës A. Q. e ka thirrur gruan e tij Sh. Q. rreth orës 08.45 dhe i ka thënë që ne do të shkojmë në Prishtinë për të marrë pajisje për vend të punës por do të kthehemi më vonë atë ditë. Pas kësaj dite viktima A. Q. është zhdukur dhe është raportuar si person i zhdukur.

33. Disa ditë pas zhdukjes së viktimës S. V. ka qenë duke vozitur veturën e viktimës. Veturën S. V. ia ka shitur A. dhe I. M. në shtator 1999 për 2.500 DM në një treg veturash në Prishtinë. Pronari i ri e ka regjistruar veturën në emër të tij në Qendrën e Regjistrimit të Veturave në Ferizaj.

34. Pasi që S. V. është larguar nga Prizreni më 9 gusht i pandehuri nuk është kthyer në shtëpinë e Sh. A. Më 16 gusht 2000, në mes fshatrave Karaqice dhe Luzhnice, janë gjetur mbetje mortore, një kafkë e çarë, eshtra të pelvisit të majtë, dhe rroba, një palë këpucë ngjyrë kafe me lidhëse, një këmishë e kaltër me mangë të shkurta dhe një palë pantallona ngjyrë kafe. Policia e UNMIK është informuar dhe ata ia kanë dorëzuar lëndën TPNJ-së në Hagë, Holandë. Më 15 shtator 2000 mbetjet e gjetura më 16 gusht 2000 janë larguar nga TPNJ. Këmisha e kaltër dhe këpucët janë marrë në këtë rast. Një shufër metali është gjetur afër eshtrave. Pas ekzaminimit ADN është vërtetuar që mbetjet ishin të viktimës A. Q. Më 10 korrik 2002 mbetje tjera, një asht nga dora e majtë dhe një nga këmba e majtë, janë zbuluar përafërsisht në të njëjtin lokacion si më parë. Më 15 korrik 2002 ekipi i zhvarrimit i ka larguar mbetjet. Përputhje pozitive ADN është bërë në shtator 2009 do të thotë është konfirmuar që mbetjet janë të trupit të viktimës. Përsëri në tetor 2002 janë gjetur mbetje shtesë, dy humeri, një fibula, një radius, disa eshtra, fragmente eshtrash, fragmente kafke dhe një copë dhëmbi të vënë. Këto janë gjetur në të njëjtin vend dhe janë zhvarrosur nga Njësia e UNMIK për Persona të Zhdukur, Ekipi i Zhvarrimit. Eshtrat ishin të përziera me



flokë. Janë gjetur gjithashtu një palë pantallona dhe një copë rripi të zi. Ekzaminimi më 5 shtator 2003 nga Zyra e UNMIK për Persona të Zhdukur dhe Forensikë ka dhënë një përputhje pozitive ADN. Në fund më 16 qershor 2012, është lëshuar certifikatë ADN nga Departamenti i Mjekësisë Forenzike, e cila tregon që të gjitha mbetjet e përmendura më lartë i përkasin trupit të viktimës A Q .

35. Autopsitë e kryera më 21 shtator 2000 dhe 5 dhjetor 2002 nga Zyra e UNMIK për Persona të Zhdukur (FZX01/001BP) në mbetjet trupore të A Q dhe rrobat e A Q nuk kanë mundur të sqarojnë modalitetet e sakta dhe rrethanat e vdekjes së A Q, prandaj nuk ka qenë e mundur të përcaktohet mënyra dhe shkaku i vdekjes.

36. Sipas raportit përmbledhës të Antropologut Forenzik T F , një plagë e gjetur në kafkë ishte mjaft e rëndë që të ketë shkaktuar vdekjen. Lëndimi ishte shkaktuar ante mortem.

37. Antropologu/arkeologu forenzik ekspert A R në gjykim më 19 dhjetor 2012 ka deklaruar: (faqja 8 nga 48):

“Kjo është një mundësi. Nuk mund të hedhim poshtë mundësi të tjera. Ne thjesht nuk kemi mjaft material për të rindërtuar traumën saktësisht.”

Pas pyetjes së prokurorit nëse lëndimi në kafkë do të ishte mjaft i rëndë për të shkaktuar vdekjen A R ka deklaruar:

“Në këtë rast duket ashtu po”.

Pas pyetjes së avokatit mbrojtës S M nëse mund të thuhet që eksperti i antropologjisë nuk mund të përcaktojë saktësisht shkakun e vdekjes, A R ka deklaruar si në vijim: (faqja 8 nga 48)

“Në duhet të kemi kujdes të bëjmë një dallim të rëndësishëm; një traumë e dhunshme është evidente në mbetjet dhe dy mundësitë më të mëdha janë lëndimi me mjet të topitur, një goditje në kokë me shumë energji, ose të shtëna në kokë; por siç thashë më parë sepse ne nuk kemi mundur të rindërtojmë tërë kafkën atëherë përcaktimi i shkakut të vdekjes nuk është i mundshëm, thjesht përmend mundësitë më të mundshme.”

“Është tentuar një rindërtim, por fatkeqësisht tepër copa mungonin.”

Pas pyetjes që i referohet datës së vdekjes A R dha këtë përgjigje:



“Me mbetje skeletore është e vështirë veçanërisht me raste të vjetra dhe metodologjia që i përket një fushe tjetër që studion insektet që shkojnë në zbrazëtirat e trupit. Kjo zakonisht ndodh gjatë një periudhe të shkurtër kohore. Mënyra tjetër është që të gjenden artefakte që nuk mund të datohen, por ato vetëm japin tregues dhe nuk japin datën e saktë. Nga dosja unë nuk shoh asnjë informacion të tillë që do të na tregonte këtë.”

Gjetjet e Gjykatës

38. Gjykata gjen se ka mungesë të provave direkte që lidhin kryerësin e pretenduar me krimin për të cilin është akuzuar. Me qëllim që të gjendet lidhja e nevojshme në mes të krimit të pretenduar dhe kryerësit një zinxhir i provave rrethimore dhe treguesve duhet të jetë aq afër sa që kërkesa për standardin e vërtetimit përtej dyshimit të arsyeshëm të jetë plotësuar. Kjo nuk është kështu në këtë lëndë.
39. Sa i përket çështjes së vdekjes së viktimës A Q dhe vrasjes së pretenduar Gjykata mbështetet në deklaratën e dëshmitarit ekspert Alan Robinson më 19 dhjetor 2012. Ai deklaroi që ekzaminimi ADN ka rezultuar pozitiv për përputhjen e mbetjeve të trupit me mbetjet e trupit të viktimës A Q. Ai më tej deklaroi bindshëm që shkak i vdekjes nuk ishte e mundshme të vërtetohej sepse rindërtimi i tërë kafkës nuk ishte i mundshëm. A R gjithashtu ka deklaruar që një objekt i topitur që ka shkaktuar lëndimin në kafkë është një mundësi por nuk mund të refuzohen mundësi të tjera. Ai ka thënë që ekspertët nuk kanë pasur mjaft material për të rindërtuar traumën saktësisht. Gjithashtu koha e vdekjes nuk ka mundur të vërtetohet. Gjykata ka lexuar raportin e T F. Mendimi i A R është i mbështetur me autopsitë dhe konkluzionet nga TPNJ më 21 shtator 2000 (NË01/001BP) dhe nga Zyra e UNMIK për Persona të Zhdukur (FX01/001BP) më 5 dhjetor 2002.
40. Gjykata gjen, në bazë të dëshmitarëve ekspert dhe provave dokumentare nga autopsitë, që shkak i vdekjes, koha e vdekjes, ku dhe si janë kryer krimi i pretenduar nuk është vërtetuar. Asnjë provë tjetër në prezantimin e provave nuk mund të ndriçojë këto çështje.
41. Gjykata gjithashtu vëren mungesën e provave që do të lidhnin kryerësin me lokacionet ku janë gjetur mbetjet e trupit të viktimës Ajdin Qereti. Nuk ka pasur prova forenzike në rrobat e marra, që do të lidhnin mbetjet e trupit të viktimës me të pandehurin, ose ndonjë provë tjetër që do të sugjeronte një lidhje në mes të vendngjarjes potenciale të krimit dhe pandehurit, për shembull vërejtjet e dëshmitarëve ose edhe dëshmi si thashetheme.




42. Në anën tjetër ka disa prova që sugjerojnë që i pandehuri mund të ketë qenë i përfshirë në zhdukjen e viktimës. I pandehuri S. V. pretendohet se i është bashkëngjitur viktimës në ditën e fundit (9 gusht 1999) kur viktima është parë i gjallë sipas deklaratës së S. V. dhe dëshmitëve thashetheme të dhëna nga gruaja e viktimës Sh. Q. S. V. e ka vozitur veturën një apo dy ditë pas zhdukjes së viktimës. Sipas deklaratës së tij S. V. e ka njohur terrenin në zonën ku janë gjetur mbetjet e viktimës. Skende V. është shoqëruar me viktimën dhe ata kanë qenë shokë. Këto rrethana përbëjnë një nivel të caktuar të provave fajësuese për të pandehurin por niveli nuk është mjaft i lartë që të përfundohet që i pandehuri ka kryer krimin me të cilin akuzohet.

43. Provat rrethimore në vijim janë adresuar nga prokurori për të vërtetuar një zinxhir të mjaftueshëm të provave për të arritur nivelin e fajësisë (pra vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm).

Supozimi që i pandehuri ka qenë njëri prej personave të fundit që ka parë viktimën gjallë nuk jep lidhje të mjaftueshme në mes të pandehurit dhe zhdukjes së viktimës. Edhe po të ishte që i pandehuri ka qenë njëri prej personave të fundit që ka parë viktimën gjallë më 9 gusht 1999 kjo nuk përbën provë që ai e ka vrarë viktimën. Ka mundësi që ndonjë person tjetër përveç të pandehurit mund të ketë qenë i përfshirë në zhdukjen e viktimës. S. V. deklaron që atë e ka marrë viktima atë ditë në shtëpinë e Sh. A. Sh. Q. deklaron që ajo ka marrë informacion nga A. Sh. dhe Sh. A. që S. V. është larguar nga shtëpia e këtij të dytit dhe së bashku me një person me emrin J. M. janë nisur për Prishtinë. Gjatë dëshmisë së tij dëshmitari J. M. ka mohuar të ketë njohuri për emrat S. V. dhe A. Sh. Ai ka deklaruar që e ka dëgjuar emrin A. Q. por nuk e njeh atë. Gjatë kohës së cekur në aktakuzë dëshmitari nuk ka punuar (?) në zonën e Prizrenit. Gjykata vlerëson që duket e arsyeshme që dëshmitari J. M. nuk ka qenë me të pandehurin më 9 gusht 1999. Gjykata nuk mund të heqë dorë nga konkluzioni që informacioni që Sh. Q. e ka marrë nga Sh. A. dhe A. Sh. nuk ka qenë i saktë.

44. Dëshmitari M. H., i cili ka qenë pronari i pompës së benzinës “ ” në mes të Prizrenit dhe Gjakovës, ka deklaruar që ai e ka parë viktimën së bashku me dy persona të tjerë të paidentifikuar në veturën e viktimës por nuk ishte i sigurt për ditën e saktë kur kjo ka ndodhur. Dëshmitari ka përmendur që ai shpesh e ka pasur viktimën klient dhe nuk i ka kushtuar vëmendje nëse viktima ka pasur pasagjerë të tjerë në veturën e tij kur ai e ka mbushur veturën me naftë. Nga kjo dëshmi nuk është e




mundshme që të vërtetohet nëse viktimë më 9 gusht 1999 kishte apo jo pasagjerë në veturën e tij.

45. Qëllimi për të vrarë viktimën nuk mund të përcaktohet vetëm nga biseda që i pandehuri ka patur me dëshmitarin A Sh. më datë 8 gusht 1999 në Malishevë gjatë një pushimi në restorant. Sipas dëshmitarit A Sh., i pandehuri kishte thënë; “ai do të shkonte me A në Prishtinë, do të merrte makinën e tij dhe do t’a kryejmë me të, sepse... A Q nuk është njeri i mirë”. Gjykata gjen se kjo deklaratë nuk përmban shprehje të qëllimit për të vrarë një person. Domethënia e kësaj deklarate nga i pandehuri mund të interpretohet si e tillë që i pandehuri ka shprehur mendimin se ai do të përfundonte negociatat me viktimën me qëllim që të blinte veturën e tij. Mund të ketë gjithashtu kuptimin se ai nuk donte që të ishte shok me të. Në një deklaratë të mëparshme A Sh. deklaroi se i pandehuri, gjatë atij rasti, kishte thënë “Ai nuk është shok, ai nuk është njeri i mirë.” Nëse A Sh. në atë kohë do të kishte interpretuar deklaratën e S. V. si qëllim për të vrarë viktimën, do të ishte pritur që A Sh. të kishte paralajmëruar atë që të mos udhëtonte me S. V. Nuk ka prova që sugjerojnë diçka të tillë. Gjithashtu duhet të merret parasysh edhe deklarata e A Sh., dhënë gjatë shqyrtimit kryesor më datë 17 mars 2011. Sipas dëshmitarit A Sh., gjatë rrugës për në Prishtinë viktimë kishte thënë se ai donte të shiste veturën dhe se i pandehuri do t’i gjente një person për t’a blerë atë. Nuk ka asgjë që sugjeron se i pandehuri është shprehur se ai do t’a vriste viktimën më datë 9 gusht 1999.

46. Lidhur me deklaratën dhënë nga A Sh., se i pandehuri nuk kishte lejuar që A Sh. të shkonte me të pandehurin dhe viktimën në Prishtinë më datë 9 gusht 1999 Gjykata gjen si e vërtetë. Në deklaratën e A Sh. më datë 23 qershor 2014 S. V. kishte thënë lidhur me udhëtimin “Ne kemi disa punë, nuk mund të të marrim ty me vete”. Trupi gjykues është i mendimit se ka shumë pak gjasa që nga kjo rrethanë të arrihet në përfundimin se i pandehuri kishte qëllimin të vriste viktimën. Domethënia e asaj që është thënë mund të interpretohet pikërisht ashtu siç është thënë, përkatësisht se i pandehuri dhe viktimë kishin disa punë për të kryer dhe se atë duhet t’a kryenin vetëm. Gjykata është e mendimit se fjalia e thënë nga i pandehuri në atë rast nuk mund të interpretohet si qëllim nga ana e të pandehurit për të vrarë viktimën. Në deklaratën e tij, dëshmitari A Sh. deklaroi se i pandehuri dhe viktimë kishin planifikuar të shkonin në Prishtinë më datë 9 gusht 1999.

47. Prokurori parashtroi gjithashtu se i pandehuri kishte motiv për të vrarë viktimën sepse ai donte që t’a kishte në posedim veturën e viktimës, Audi




80. Gjatë disa rasteve i pandehuri ka theksuar se ai kishte blerë veturën e nga viktimë më datë 9 gusht 1999. Blerja u bë në “Kafe Kosova” afër spitalit në Prizren. I pandehuri ka paguar A. Q. shumën prej 2.100 DM. Sipas S. V., një person me emrin A., për të cilin thuhet se jeton në Ferizaj dhe i cili njihej si fytyrë dhe me mbiemër nga i pandehuri, kishte qenë dëshmitar gjatë blerjes. Prokurori parashtron se më datë 9 gusht nuk është bërë asnjë shit-blerje mes S. V. dhe viktimës. Ai arrin në këtë përfundim në bazë të rrethanave vijuese;

48. Sipas gruas së viktimës, Sh. Q., viktimë nuk ka patur qëllim të shesë veturën dhe çifti ishte kishte gjendje financiare të qëndrueshme në gusht 1999. Megjithatë, duhet të shënohet se viktimë nuk i tregoi bashkëshortes më datë 8 gusht 1999 lidhur me planet që kishte për të shkuar në Prishtinë, më datë 9 gusht 1999, ai e bëri këtë në mëngjes kur e thirri gruan në telefon nga shtëpia për t’a informuar mbi udhëtimin për në Prishtinë. Kjo tregon se viktimë kishte disa punë me të pandehurin gjë për të cilën gruaja e tij nuk ishte në dijeni dhe që viktimë nuk donte që ajo t’a dinte. Ka mundësi që ai kishte qëllim të shiste makinën por ai nuk donte të përfshinte gruan e tij në këtë gjë. Viktimë kishte më shumë se një veturë në atë kohë, sipas deklaratës së gruas, gjë e cila do të thotë se ai do të kishte një veturë edhe pas shitjes së Audi 80. Prokurori deklaroi se i pandehuri nuk kishte të holla të mjaftueshme për të blerë veturën.

49. Sipas deklaratës së të pandehurit ai posedonte rreth 6000 – 7000 DM nga puna që kishte bërë në Gjermani. Atij i ishin dhënë të holla edhe nga babai i tij dhe për më tepër ai kishte edhe një pension. I pandehuri ishte gjithashtu bashkë-pronar toke dhe prone në Maqedoni. Gjykata vlerëson se në atë kohë i pandehuri kishte burime financiare për të vlerë veturën.

50. Prokurori parashtron gjithashtu se mungesa e kontratës me shkrim lidhur me blerjen e veturës është tregues se blerja nuk ka ndodhur. Gjykata është e mendimit se përse i përket kësaj duhet të merren parasysh edhe kushtet në Kosovë në kohën e kryerjes së vrasjes së pretenduar. Në atë kohë Kosova ishte shesh luftimi gjë e cila do të thotë se kushtet ishin të ndryshme nga ndonjë territor tjetër me politikë të qëndrueshme. Trupi gjykues është i mendimit se mungesa e një kontrate të shkuar lidhur me shit-blerjen e veturës nuk mund të çojë në përfundimin se i pandehuri ishte përgjegjës për vdekjen e viktimës. As fakti se S. V. nuk e mbajti veturën por se e shiti për 2.500 DM. Përkundrazi, kjo ka relevancë shtesë duke patur parasysh se çmimi të cilin i pandehuri pretendon se ka paguar, 2.100 DM dhe çmimin që ka marrë, 2.500 DM, nga shiteshi i radhës janë të ulëta, edhe kur konsiderohet vlera e të hollave në atë kohë. Gjykata vlerëson se arsyeja e dhënë nga i pandehuri se pse ka shitur




veturën është e pranueshme dhe nuk përbën ndonjë tregues se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

51. Dëshmitari i pretenduar i shit-blerjes (A) nuk u gjet ku ishte. S V jep shpjegim të arsyeshëm në deklaratën e datës 19 dhjetor 2012 dhe atë të datës 27 qershor 2014; Ai deklaron ai është njohur me A në spital, në Prizren. S V nuk arriti të gjente mbiemrin e A sepse në atë kohë policia i kishte thënë se ata do ta bënin një gjë të tillë dhe policia i kishte thënë atij gjithashtu që të mos fliste e asnjë nga dëshmitarët dhe të mos shkonte në Prizren. Trupi gjykues gjen këtë shpjegim të mundshëm dhe të pranueshëm.

52. S V deklaroi se ai shkonte e vizitonte familjen në zonën ku u gjetën mbetjet mortore të viktimës. Kjo është provë rrethore por ajo nuk siguron një lidhje ekskluzive mes të pandehurit dhe zonës ku u gjetjen mbetjet mortore. Edhe deklarata e dëshmitarit H: K i cili në atë kohë jetonte në Shtime, në të cilën ai deklaroi se i pandehuri kishte shkuar një pasdite në shtëpinë e tij me një Audi të kuq nuk ndryshon pikëpamjen e trupit gjykues.

53. Prokurori i referohet gjithashtu edhe njohurive të të pandehurit të armëve si provë tjetër rrethore. Trupi gjykues është i mendimit se gjatë kohës që ai ka qenë ushtar i UÇK-së i pandehuri pa përfituar njohuri mbi armët si çdo ushtar tjetër.

54. Trupi gjykues gjen se gjendja shëndetësore e të pandehurit në gusht 1999 e në vazhdim është diçka që duhet të merret në konsideratë. Është fakt se S V në qershor 1999 ishte lënduar në këmbën e djathtë nga shrapnel. Ai ishte shtruar në spitale të ndryshme dhe kishte pasur disa operacione. Ai përdorte paterica dhe sipas dëshmitarit A Sh i pandehuri ishte pak i gjymtuar. Lëndimi dhe numri i operacioneve duhet të ketë patur ndikim në aftësinë e tij për të ecur dhe në peshën e këmbës së plagosur. Pjesë të mbetjeve mortore të trupit të viktimës u gjetën afër fshatit Karaqice. Kjo zonë, sipas S V dhe Google Earth është një zonë shumë rurale. Vendndodhja e mbetjeve mortore të trupit të viktimës ka qenë rreth 7-8 kilometër nga fshati Karaqice. Trupi gjykues është i mendimit se duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore të të pandehurit nuk ka gjasa që a të ketë qenë në gjendje të transportojë një kufomë të rëndë për një distancë të gjatë, apo qoftë edhe të ketë përdorur kalë si mjet transporti sepse një gjë e tillë do të krijonte të njëjtin problem. Nuk ka gjasa që nëse i pandehuri dhe viktimë kanë ecur së bashku në atë zonë të izoluar dhe rurale që i pandehuri pastaj të ketë vrarë viktimën. Gjykata vlerëson se gjendja shëndetësore e të pandehurit dhe vendndodhja



e mbetjeve mortore hedhin dyshime mbi mundësinë që i pandehuri të ketë kryer krimin e pretenduar.

55. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e përmendura, gjykata nuk mund të përcaktojë asnjë motiv të qëndrueshëm të të pandehurit për të vrarë viktimën. Ata ishin shokë, viktimja transportoi të pandehurin, ai e ndihmoi atë që të gjente një vend për të qëndruar pasi ai kishte dalë nga spitali në Prizren, ai u shoqërua me viktimën dhe gjithashtu disa herë ai e dërgoi me makinë të pandehurin në spitalin e Prishtinës. Në atë kohë i pandehuri kishte disa burime të ardhurash dhe ai ishte bashkëpronar toke dhe prone. Gjykata nuk mund të gjejë asnjë motiv të fortë të të pandehurit për krimin me të cilin ai akuzohet.

56. Prokurori deklaroi se i pandehuri S V ka ndryshuar tregimin e tij disa herë gjatë hetimeve dhe tre shqyrtimeve kryesore. Gjykata është e mendimit se që nga marrja në pyetje në vitin 2004 kanë kaluar tashmë dhjetë vjet me pasojën normale që atij gjërat nuk i kujtohen më mirë. Disa herë S V ka shpjeguar në deklaratat e ndryshme se nuk i kujtohet, se ai ka harruar për shkak të kohës së kaluar. Gjykata gjen këtë shpjegim të pranueshëm.

57. Në fjalën e tij përfundimtare me shkrim dhe me gojë Prokurori pretendon se i pandehuri ose e ka qëlluar viktimën në kokë me armë zjarri ose e ka qëlluar atë shumë fort me një mjet të topitur duke shkaktuar vdekjen e viktimës. Gjykata vëren veçanërisht faktin se gjatë paraqitjes së provave nga ana e prokurorit nuk është bërë asnjë referencë arme përdorur nga ana e të pandehurit përveç faktit se i pandehuri ka konfirmuar faktin se ai kishte njohuri lidhur me armët sepse ka qenë ushtar. Nuk ka asnjë lloj prove që tregon se i pandehuri ka patur në posedim ndonjë armë në kohën e vrasjes së pretenduar.

PËRFUNDIM

Trupi gjykues nuk mund të nxjerrë përfundimin përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri është i përgjegjshëm për vdekjen e viktimës A Q ose se ka shtënë me armë zjarri viktimën në kokën ose se e ka qëlluar atë shumë fort me një mjet të topitur duke shkaktuar vdekjen e tij dhe se pastaj e ka varrosur atë në një varr të çekët jashtë fshatit Karaqice.

Trupi Gjykues gjen se nuk është përcaktuar shkaku i vdekjes së viktimës A Q apo rrethanat në të cilat viktimja është vrarë, si është kryer vrasja e



pretenduar ku dhe kur është kryer vrasja e pretenduar. Në bazë të paraqitjes së provave trupi gjykues arrin në përfundimin se provat përmbajnë më pak prova të drejtpërdrejta dhe më shumë tregues dhe prova rrethanore. Në fund trupi gjykues arrin në përfundimin se ekzistojnë prova rrethanore por se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, kur merren parasysh të gjitha rrethanat, për të arritur në përfundimin se i pandehuri ka kryer veprën në të cilën akuzohet.

Vlerësimi ligjor


Në pajtim me nenin 390 paragrafi 3, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) i pandehuri lirohet nga akuza e veprës penale.

Për këtë arsye është vendosur si në dispozitiv.

Kryetarja e Panelit
Gjyqtarja Marie Tuma

Gjyqtari Skender Çoçaj

Gjyqtari Artan Sejrani



Mjet ligjor:

Në pajtim me Nenin 400, paragrafi 1, KPPK, ankesa duhet të lajmërohet brenda 8 ditësh nga shpallja e aktgjykimit pranë gjykatës së shkallës së parë.

Në pajtim me Nenin 398, paragrafi 1, KPPK, palët e autorizuara kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë me shkrim përmes Gjykatës Themelore të Prizrenit në Gjykatën e Apelit, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur palët kanë pranuar aktgjykimin.